



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prigaturo Received/Delivery	29.12.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIMSHICK	7743	/2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1354/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1354/2023 të datës 31.10.2023 të ankuesit nga Vushtrria, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2023, mori këtë.

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me A.nr.1354/2023 të datës 31.10.2023 e parashtruara nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit "Inspektor i Komunikacionit" të shpallur nga Komuna e Vushtrrisë, me datë 31.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e regjistruar me numër protokolli 6779/2023, kundër datës 27.10.2023 me numër:52126/23 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, ankesë të cilën e ka plotësuar përmes parashtresës së datës 02.11.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Vushtrrisë pa të drejtë ia ka refuzuar aplikacionin për konkursin e shpallur ngase i njëjti i ka dy (2) vite e tetë (8) muaj përvojë pune pas diplomimit, me arsyetimin se të njëjtit këtë përvojë të punës ia kishte njohur paraprakisht në një konkurs tjetër për pozitën "Inspektor i Shërbimeve Publike" nga Komuna e Vushtrrisë, duke e përfshirë ankuesin në listën e ngushtë për të vazhduar tutje me procedurat e rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, e ka proceduar me datë 07.11.2023 kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Vushtrrisë, ndërsa Këshilli me datë 15.11.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 31.10.2023 të parashtruar në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Parashtrësë për plotësimin e ankesës të datës 02.11.2023; Vendimi i datës 27.10.2023 me numër:52126/23 i Divizionit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë; Njoftimin e datës 19.10.2023; Pasqyrën e llogarisë së trustit për ankuesin; Diplomën e datës 30.12.2015; Diplomën e datës 01.09.2020; Diplomën e datës 20.06.2000; Çertifikatë e datës 07.06.2021; Licencë e datës 17.03.2022; Letër rekomandimin e datës 04.05.2022; Kontratë pune e datës 01.01.2023; Letër rekomandim i datës 05.03.2023; Çertifikatë e datës 28.09.2023; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2023; Përgjigje në kërkesë të datës 08.11.2023; Konkursin e datës 06.09.2023; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e ankuesit të datës 28.09.2023; Referencë e lëshuar nga SH.P.K "Ylli-Pashtriku"; Vërtetimin e datës 20.11.2020; Letër rekomandimin e datës 04.05.2022; Letër rekomandimin e datës 05.03.2023; Njoftimin e datës 27.10.2023; Zarkin postar me shifër R5592518;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna e Vushtrrisë, me datë 06.09.2023 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit (*pranim*), emri i grupit Specialist i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën "*Inspektor i Komunikacionit*", Klasa e pozitës-Profesional 1, me numër të Referencës RN00012474, ndërsa në bazë të aplikacionit të datës 28.09.2023 konstatohet fakti se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs, mirëpo të njëjtit i është refuzuar aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak përmes vendimit të datës 27.10.2023 me numër:52126/23 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vushtrrisë, me arsyetimin se ankues nuk e ka plotësuar kriterin e përcaktuar të konkursit lidhur me përvojën e punës profesionale prej dy (2) vitesh në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, ndërsa sipas me datë 27.10.2023 Komuna e Vushtrrisë ka publiku Njoftimit me numër: 052127/23 përmes të cilit konstaton se asnjëri nga kandidatët në procedurë nuk i plotëson kriteret dhe të veçanta të konkursit të shpallur të datës 06.09.2023.

Kolegji i Këshilli, ka analizuar shpalljen e konkursit të datës 06.09.2023 me numër të Referencës RN00012474 për pozitën "*Inspektor i Komunikacionit*", ndërsa kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Fakulteti Teknik-Drejtimi Komunikacion*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Se paku një (2) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi aplikacionin e ankuesit të datës 28.09.2023 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur dhe ka gjetur se ankuesi posedon Diplomën e datës 30.12.2015 me shifër:37/15 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti me datë 13.11.2015 i ka përfunduar studimet themelore në Kolegjin e Shkencave të Aplikuara Teknike Tempulli dhe ka marrë titullin Bachelor i Arteve në Trafikun Rrugor dhe Transport, po ashtu posedon Diplomën e datës 01.09.2020 përmes së cilës dëshmohet se i njëjti me datë 24.06.2020 i ka përfunduar studimet Master

në Kolegjin e Shkencave të Aplikuara Teknike Tempulli dhe ka marrë titullin Master i Arteve në Trafikun Rrugor dhe Transport, ndërsa lidhur me përvojën e punës ankuesi posedon Vërtetimin e datës 20.11.2020 të lëshuar nga Fluidi Sh.P.K përmes së cilit dëshmohet se i njëjti nga data 01.04.2014 e deri me datë 31.12.2016 (2 vite e nëntë muaj) ka qenë i punësuar në këtë kompani në pozitën e punës "voztës", sipas Letër rekomandimit të datës 04.05.2020 të Njesisë së Personelit të Komunës së Vushtrrisë dëshmohet se i njëjti nga data 11.08.2021 e deri me datë 10.12.2021 (4 muaj) ka qenë i punësuar përmes kontratës mbi vepër-punë specifike (çështje që kanë të bëjnë me inspektime dhe komunikacion) në Komunën e Vushtrrisë në pozitën e punës "voztës", sipas letër rekomandimit të datës 05.03.2023 të lëshuar nga Barnatore Bujqësore "Agrokultura" nga data 01.08.2022 e deri me datë 28.02.2023 (7 muaj) ka qenë i punësuar në këtë kompani në pozitën e punës "menaxher i shitjes", sipas kontratës së datës 01.01.2023 të lëshuar nga Auto shkolla Prishtina nga data 01.01.2023 (me afat deri me datë 16.03.2027) është i punësuar në këtë kompani në pozitën e punës "ligjërues" dhe po të njëjtit përvoja të punës të konstatuar si më lartë i ka të mbështetura edhe me pasqyrën e llogarisë nga Trusti.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë kriteret e konkursit që lidhen me përvojën e punës si në vijim: "Se paku një (2) vit përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës", iu referuar dispozitave të nenit 18 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "Përvoja profesionale dhe/apo menaxheriale llogaritet pas diplomimit në ciklin e parë të studimeve themelore", dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesi me datë 13.11.2015 i ka përfunduar studimet në ciklin themelor, gjegjësisht i njëjti nuk i ka dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura, ngase pozita e "voztës" të cilën ankuesi e ka paraqitur si përvojë punë nuk hynë në fushën për të cilën zhvillohet procedura dhe po ashtu, pozita "menaxher i shitjes", të cilën ankuesi e ka paraqitur si përvojë punë nuk hynë në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, ndërsa si përvojë punë profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit i llogaritet përvoja e punës si "ligjërues", në Auto shkollën Prishtina (prej 9-nëntë muajsh) dhe përvoja e punës në Komunën e Vushtrrisë prej katër (4) muaj, pra gjithsejtë një (1) vit e një (1) muaj përvojë pune profesionale e cila nuk është e mjaftueshme për tu përmbushur kriteri prej dy (2) vitesh përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura.

Kolegji i Këshilli, mbështetur në mandatin kushtues që ka të bëjë me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil, ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes." përveç shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ku përcaktohet se: "Klasat dhe emërtesat e pozitave të punës në kategorinë profesionale. Klasat përbërëse të kategorisë profesionale dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1, Profesional 2, Profesional 3", ndërlidhur me Shtojcën Nr.1/6: Përshkrimi i Përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1., ku kërkesat e përgjithshme formale janë të përcaktuara si në vijim: a) **Arsimimi i kërkuar:** a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); c) **Përvoja e punës e kërkuar:** Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, lidhur me Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm, ku për pozitën "58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm, Fusha e kërkuar e arsimit: Arsim i lartë i paspecifikuar" dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komuna e Vushtrrisë konkursin e shpallur të datës 06.09.2023 e ka bërë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.



10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil-lidhur me Shtojcën Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm, pasi për këtë grup të administrimi, arsimi i lartë nuk është i specifikuar, ndërsa Komuna e Vushtrrisë e ka shtuar si kriter Fakultetin Teknik-Drejtimi Komunikacion, mirëpo sipas njoftimit të datës 27.10.2023 me shifër:052127/23 konstatohet fakti se kjo procedurë e rekrutimit e iniciuar sipas konkursit të datës 06.09.2023 ka përfunduar.

Kolegji i Këshillit nga se u tha si më lartë në konstatimet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi duke marrë përbazë depozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vlerëson se çështja e shpalljes së konkursit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara tani më nuk ka objekt shqyrtimi ngase kjo procedura ka përfunduar qysh pas fazës së verifikimit paraprak, kurse lidhur me pretendimin ankimore të ankuesit sikurse u sqarua edhe në arsyetimin e dhënë edhe më lartë ankesa e të njëjtit është e pabazuar, andaj duke marrë përbazë rrethanat e shqyrtimit administrativ u vendos sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa sikurse konkursi mos të kishte përfunduar sipas njoftimit të datës 27.10.2023 i njëjti do të anulohet përmes këtij shqyrtim administrativ.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1354/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.